

Infrastrukture

Data	Premtimi	Linku	Screenshot
------	----------	-------	------------

1. Hyrja e Qytetit, Kartolina Europiane e Shqipërisë Projekti përfshin krijimin e një **parku buzë Bunës** e cila do të krijojë parkun më të madh çlodhës dhe argëtues në Shkodër. Parku , përveçse në lulishten e vjetër do të shtrihet edhe në zonën mes dy bypasseve (Lot 1 dhe 2) duke krijuar një Koncept të ri të një parku sportiv e funksionesh të tjera rekreative që bashkëjeton me përmbytjet sezonale kur ngrihet niveli i Liqenit në dimër.. Parku do të jetë një mushkëri e qyteti plot me gjelbërim me një sipërfaqe prej rreth 18 hektarë dhe do të krijojë një marrëdhënie të re mes qytetit e liqenit si një bashkëjetesë ekologjike e në respekt të vlerave mjedisore; Një rrjet rrugësh e rrugicash për këmbësorë e biçikleta që lidhin natyrën me rrugë panoramike; një vendtakim të jashtëzakonshëm për evente publike; portin pranë urës së Bunës si një pol turistik për



<https://shkodrapozitive.com/programi-projekte-3/>





Programi i transformimit urban të Shkodrës.

- **Transformimin urban të akseve kryesore të qytetit** me trotuare të rregullta e të çliruara, korsi biçiklete të dedikuar, gjelbërim të bollshëm, fasada të unifikuara e ndriçim të përshtatshëm. Masa të nevojshme për përmirësimin e qarkullimit si semaforë, vija të bardha për kalimin e këmbësoreve, trotuare të përshtatshme për persona me aftësi të kufizuar. Si projekt model, i cili do të shtrihet edhe në zonat e tjera , për këtë qëllim ,do të jetë **rivitalizimin e bulevardit Zogu 1 nga Xhabija e deri në Qendër** i cili do të kthehet në një korridor të bukur urban lidh pikat më tërheqëse të qytetit mes parkut të Bunës dhe qendrës së qytetit duke krijuar një fytyrë të re për qytetin dhe krijuar mundësi të reja për bizneset përgjatë këtij aksi.
- Rekuperimi dhe investimi kudo është i mundur të **hapësirave**

<https://shkodrapozitive.com/programi-projekte-3/>

• ○ ○ R
i
k
o
n
s
t
r
u
k
s
i
o
n
i
d
h
e
m
u
z
e
a
l
i
z
i
m
i
i
M
u
z
e
u
t
H
i
s
t
o
r
i
k
t
ë
S
h
k
o
d
r
ë
s
n
ë
k
a
l
a
.
○ M

<p>10/5/2023</p>	<p>-Ura e Bunes qe lidh Ulqinin me Velipojen -Rruga qe lidh Shiroken me Zogajn -Rruga nepermjet Dukagjinit qe shkon ne Gjakove -Projekti per hyrjen e Shkodres (Porta Hyrese)</p>	<p>https://fb.watch/ktKENbqlKY/</p>	
<p>5/5/2023</p>	<p>Radhën tani e ka rruga e Dukagjinit, për t'i dhënë vëmendjen dhe zhvillimin që i takon!</p>		
<p>5/5/2023</p>	<p>Përfundimi i rrugës së re të Velipojës dhe ura mbi Bunë.</p> <p>Një nga projektet kryesore për ndërlidhjen e Shkodrës edhe me territoret përreth është përfundimi i pjesës së fundit të rrugës nga Qafë Shtiqën në Velipojë Plazh dhe ura e re mbi lumin Bunë në fshatin Pulaj, lidhja e re drejt Ulqinit. Ky projekt ka përfitime të shumëfishta:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Do të kompletohet rruga Shkodër-Velipojë për një akses të shpejtë mes Shkodrës dhe Velipojës. Së bashku me zgjerimin e rrugës hyrëse për në Shkodër nga Harku i Bërdicës, udhëtimi Shkodër-Velipojë do të jetë më i shpejtë dhe i sigurt. - Do të përfundohet lidhja mes Velipojës dhe Shëngjinit duke shkurtuar me më shumë se një orë e gjysmë distancën mes tyre. - Do të ndërtohet rruga lidhëse dhe ura e re mbi Bunë drejt Ulqinit duke shkurtuar më shumë se një orë e gjysmë distancën mes dy qyteteve. <p>Ura e re mbi Bunë do të shpëtojë edhe si një pikë e re e kalimit të kufirit kryesorit gjatë sezontit veror dhe do të krijojë mënyra të reja për të shfrytëzuar tërësisht kapacitetin e plazhëve të rivikut dhe të rrethësive të Ajullatit. Ky investim do të vlerësojë shumë më tepër cilësitë e Velipojës dhe Shtëpisë duke sjellë me shumë burime dhe gjeneruar me shumë ekonomitë për banorët dhe bizneset në zonë dhe vlerë të provave të tyre, duke u bërë një destinacion shumë i ri për investimet në rrugë. Velipojë do të jetë qyteti i dytë i bashkisë Shkodër. Projekti do të valorizojë edhe të gjithë zonën rurale të Nënshkodrës në breg të Bunës mes Shkodrës dhe Velipojës për të ngritur me shumë prodhimin bujqësor dhe turistik me bazë natyrale në zonë. Nuk kemi asnjë ditë kohë për të humbur me diskutime të panevojshme. Fillojmë punën! #shkodra</p>		

<p>4/5/2023</p>	<p>projekti Porta e Alpeve.</p>		
<p>3/5/2023</p>	<p>Projektet strategjike për Shkodrën- Business Park North (BPN) Parku i Biznesit i Veriut.</p>		
<p>27/4/2023</p>	<p>NË 4 VITET E ARDHSHMË NUK DO TË KETË ASNJË RRUGË TË PAASFALTUAR NË QYTETIN SHKODËR!</p>		
<p>26/4/2023</p>	<p>HYRJA E SHKODRES, PARKU LIGATINOR DHE FUSHAT E SPORTIT</p>	<p>https://www.facebook.com/beci.benet/posts/pfbid0JEVhumpZQXizuEkUN14c4dGB8avTxUCE3B2HbdBVH5HfszGYkQzDcvBJt1hnSJbkl?_cft__[0]=AZW07xCijzTSiyaKpNRwAJMWA92C4yvytKMUAWey0PwoLsN0DqQ6C10_WRx3crokJwxhbXvXkIBuFBotXtVgdJ0L_zd-a6795Ti-2JLXRr8uRW-fXo0UaHf-yFQVJOh9YxibA4VfQMhXE90InjGKDsyoSeUPsvDSOAtqad42DIt5xkdmdJWtWSbYPVogCKn611g&_t_n_=%2C0%2CP-R</p>	

13/4/2023

Me banorët e Rrethinave. Në një komunitet të madh ku problemet e infrastrukturës janë shqetësuese. Shkolla e mesme mungon në këtë zonë, ndërsa uji i pijshëm ka cilësi për t'u përdorur për vaditje, por jo për konsum familjar. Mbeturinat, mungesa e transportit publik ... është e gjatë.

Çfarë mund të bëjë bashkia me burimet e veta për këto shqetësime?

Shumë më tepër sesa sot:

- Mund dhe duhet të kemi një qytet dhe fshatra shumë më të pastër se sa kemi sot.
- Mund dhe duhet të kemi një kontroll më të mirë të territorit dhe të hapësirave publike.
- Mund dhe do të kemi një transport publik që mbulon gjithë qytetin dhe fshatrat më të mëdhenj që të jenë praktikisht pjesë e qytetit.
- Mund dhe do të kemi një rrjet të mbrojtur të korsive të biçikletave.
- Mund dhe do të kemi trotuare të çliruara, të investuara e të mirëmbajtura.
- Mund dhe do të kemi rrugë të fshatrave të investuara e të mirëmbajtura.
- Mund dhe do të kemi shkolla të pastra, të ngrohta, të mirëmbajtura dhe terrene shkollore sportive të përshtatshme.
- Mund dhe do të kemi lagje të pastra, të sigurta e të ndriçuara.
- Mund dhe do të kemi shërbim më cilësor në shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.



31/3/2023

Me banorët e Bahçallëkut, të rinj a të moshuar që ndajnë shqetësimet e tyre për çështje që ndikojnë përditshmërinë. Problemet me trafikun a sinjalistikën në rrugën hyrëse janë të mëdha. Mbikalimi në rrugën kryesore hyrëse për në Shkodër nuk është i përshtatshëm as për të moshuarit, as për fëmijët në karroca apo personat me aftësi të kufizuara. Këto çështje kanë nevojë për zgjidhje të mirëmenduara e përfundimtare, me buxhete të konsiderueshme e bashkëpunim me qeverinë dhe me donatorë.



Revision #1

Created 2023-09-20 13:22:01 UTC by P. P

Updated 2023-09-20 13:30:38 UTC by P. P